<p style="text-align: center;"><b>Neni 36</b> <b>Ruajtja e të dhënave hetimore</b></p> <p>1. Të gjitha materialet hetimore për shkelje disiplinore, pa marrë parasysh prej nga rrjedhin apo kush i kryen, duhet t'i dërgohen Drejtorisë së Standardeve Profesionale, për ruajtje.</p> <p>2. Raporti përfundimtar origjinal i kompletuar i hetimit dhe masa e shqiptuar, duhet të vendoset në dosjet e përhershme të Drejtorisë së Standardeve Profesionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 36</b> <b>Storage of investigative data</b></p> <p>1. All the investigation materials for disciplinary offence regardless where they come from or who performs should be sent to the Directorate of Professional Standards, for storage.</p> <p>2. The final original completed report of investigation and the imposed measure, must be put in the permanent dossier of the Directorate of Professional Standards in the General Directorate of Police;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 36</b> <b>Čuvanje istražnih podataka</b></p> <p>1. Celokupni istražni materijal disciplinske povrede, bez obzira od koga potiču ili ko ih izvršava, treba da se dostave Direkciji Profesionalnih Standarda, za čuvanje.</p> <p>2. Konačni orginalni kompletni izveštaj istrage i izrečena mera, treba da se ubaci i stalni dosije Direkcije Profesionalnih Standarda u Generalnu Direkciju Policije;</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 37</b> <b>E drejta për qasje në materialin hetimor</b></p> <p>1. Dosjet e kompletuara disiplinore duhet të jenë në dispozicion për shqyrtim për KBD, KA, për shefin dhe hetuesin e DSP-së, Drejtorinë e DSP-së, menaxherin e</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 37</b> <b>The right of access to investigative material</b></p> <p>1. The completed disciplinary dossier must be available to be reviewed by the IDC, CA, the head and investigator of the DPS, Directorate of DPS, DPS manager of</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 37</b> <b>Pravo pristupa u istražnom materijalu</b></p> <p>1. Kompletni disciplinski dosije treba da budu na raspolaganje za razmatranje za UDK. KŽ, za šefa i istražitelja DPS-a, Direkciju DPS-a, menadžera slučajeva</p>

<p>rasteve-data bazës të DSP-së dhe inspektorin hetues të IPK-së sipas kërkesës.</p> <p>2. Me aprovimin me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm, në lëndët hetimore të kompletuara, mund t'u lejohet qasje njësiteve përkatëse të Policisë, me procedurë të kthimit të lëndës përsëri në Drejtorinë për Standarde Profesionale, institucioneve apo shoqatave jashtë Policisë së Kosovës, të cilat shprehin interesim për studime dhe analiza, mbështetur në Ligjin mbi qasje në dokumentet zyrtare;</p> <p>3. Në raportet e kompletuara të hetimeve, kanë qasje Avokati i Popullit dhe IPK-ja.</p>	<p>cases-database and investigation inspector of KPI, according to the request.</p> <p>2. Respective units of Police may have access in the completed investigative cases only with the approval of the general director, with the returning procedure of the cases in the Directorate for Professional Standards. According to the written request, access to these cases may also have other institutions or societies out of Kosovo Police, which expresses interest, studies and analysis based on the Law on Access to Official documents;</p> <p>3. KPI and the Ombudsperson may have access to the completed investigation reports.</p>	<p>baze podataka DPS i istražnog inspektora IPK-a prema zahtevu.</p> <p>2. Po odobrenju i pismenom usvajanju Generalnog Direktora, u kompletnom istražnom predmetu, može da se odobri pristup dotičnim jedinicama Policije, po proceduri ponovnog vraćanja predmeta u Direkciji Profesionalnih Standada. Prema pismenom zahtevu, pristup može da se odobri institucijama iliudruženjima van Policije Kosova, koje izražavaju interesovanje za studiranje i analize, na osnovu Zakona o pristupu u službenu dokumentaciju.</p> <p>3. U kompletiranim istražnim predmetima, pristup imaju Narodni Advokat i IPK-va.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 38</b> <b>Dorëheqja, gjatë procesit hetimore dhe pushimi i procedurës hetimore</b></p> <p>1. Në çdo fazë të hetimeve të brendshme, punonjësi i Policisë, ka të drejtë të japë dorëheqje vullnetare nga Policia.</p> <p>2. Nëse jep dorëheqje, ai/ajo, dhe është duke u hetuar për shkelje të rëndë, nuk mund të ri punësohet;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 38</b> <b>Resignation, during the investigation process and cease of the investigation procedure</b></p> <p>1. At any phase of the internal investigations, police employee has the right to resign voluntarily from the Police.</p> <p>2. If the police resigns, and is being investigated for any serious offence, he/she can not be rehired;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 38</b> <b>Ostavka, tokom istražnog procesa i mirovanje istražne procedure</b></p> <p>1. U svakoj fazi unutrašnje istrage, radnik Policije, ima pravo da podnese dobrovoljnu ostavku iz Policije.</p> <p>2. Ukoliko podonosi ostaku, on/ona, a u toku je istraga za tešku povredu, nemože ponovo da se zaposli;</p>



<p>3. Pa marrë parasysh se në cilën fazë të hetimeve punonjësi jep dorëheqje nga Policia hetimi duhet të kompletohet dhe të ruhen në Drejtorinë për Standarde Profesionale, pa marrë parasysh se a e ka kryer intervistën apo jo;</p> <p>4. Një kopje e dorëheqjes dhe i tërë dokumentacioni përcjellës i dorëheqjes duhet të vendoset në dosjen personale të punonjësit.</p> <p>5. Drejtoria e Standardeve Profesionale rekomandon pushimin e procedurën hetimore në çdo fazë të hetimeve të brendshme, nëse punonjësi i dyshuar:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>5.1. jep dorëheqje vullnetare;</li> <li>5.2. vdes;</li> <li>5.3. pensionohet;</li> <li>5.4. nëse konstatohet se ka kaluar afati i parashkrimit, para se të fillojë procedura disiplinore;</li> <li>5.5. nëse i është ndërprerë marrëdhënia e punës me vendim të ekzekutueshëm administrativ për ndonjë rast tjetër; dhe</li> </ol> <p>6. Për të gjitha këto lëndë, vendim sjell Komisioni i brendshëm disiplinor si shkallë e parë.</p>	<p>3. No matter at what stage of the investigations the employee resigns from the Police, the investigation must be completed and kept in the Directorate of Professional Standards, regardless whether conducted the interview or not;</p> <p>4. A copy of resignation and the whole documentation of resignation must be put in the personal dossier of the employee.</p> <p>5. The Directorate of Professional Standards recommends the cease of investigation procedure in any phase of internal investigations, if the suspected employee:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>5.1. voluntarily resigns;</li> <li>5.2. dies;</li> <li>5.3. retires;</li> <li>5.4. if found that the limitation period has passed, before the disciplinary procedure begins;</li> <li>5.5. if the work relation has been terminated with the administrative executive decision for any other case;</li> </ol> <p>6. For all these cases, Internal Disciplinary Commission makes decision as the first instance.</p>	<p>3. Bez obzira u kojoj fazi istrage radnik podnosi ostavku iz Policije, istraga mora da se kompletira i da se čuva u Direkciju za Profesionalne Standarde, bez obzira da li je intervjuisan ili ne;</p> <p>4. Jedan primerak ostavke i cela prateća dokumentacija ostavke treba da se unese u lični dosije radnika.</p> <p>5. Direkcija profesionalnih standarda preporučuje mirovanje istražne procedure u svakoj fazi unutrašnje strage ukoliko osumnjičeni radnik:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>5.1. Daje dobrovoljnu ostavku;</li> <li>5.2. umire;</li> <li>5.3. penzioniše</li> <li>5.4. ukoliko se ustanovi da je istekao rok zastarevanja, pre nego što počne disciplinska procedura.</li> <li>5.5. ukoliko mu je prekinut radoni odnos izvršnom administrativnom odlukom za neki drugi slučaj.</li> </ol> <p>6. Za sve ove predmete, odluku donosi Unustrasnja disciplinaska komisija kao prvi stepen.</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 39</b> <b>Inicimi i procedurës disiplinore</b></p> <p>1. Inicimi i procedurës disiplinore bëhet:</p> <p>1.1. Sipas ankesave të qytetarëve; 1.2. Sipas inicimit të brendshëm dhe 1.3. Sipas detyrës zyrtare.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 39</b> <b>Initiation of the disciplinary procedure</b></p> <p>1. Initiation of the disciplinary procedure is done:</p> <p>1.1. According to the citizens complaints; 1.2. Internal initiation and 1.3. According to official duty.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 39</b> <b>Pokretanje disciplinskog postupka</b></p> <p>1. Pokretanje disciplinskog postuaka vrši se:</p> <p>1.1. Prema žalbama gradjana; 1.2. Prema unutrašnjeg pokretanja i 1.3. Prema Službenoj dužnosti.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 40</b> <b>Evidentimi</b></p> <p>1. Shkelja disiplinore që pretendohet se ka kryer punonjësi, përkatësisht ankesat e qytetarëve, mund të drejtohet apo raportohet me shkrim ose me gojë tek çdo punonjës i Policisë apo stacion më të afërt policor nga:</p> <p>1.1. Çdo shtetas i Kosovës, i huaj ose pa shtetësi, 1.2. Punonjësi i Policisë, 1.3. punonjësi i Inspektoratit Policor të Kosovës, 1.4. Përfaqësues të personave juridikë, 1.5. Përfaqësuesi i institucioneve të administratës publike.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 40</b> <b>Evidencing</b></p> <p>1. Disciplinary offence pretended to be committed by the employee, respectively citizen's complaints, may be addressed or reported in writing and orally to any Police employee or to the nearest police station from:</p> <p>1.1. Any Kosovo citizen, foreigner or stateless 1.2. Police employee, 1.3. Employee of the Kosovo Police Inspectorate, 1.4. Representatives of the legal persons, 1.5. Representative of institutions and public administration</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 40</b> <b>Evidentiranje</b></p> <p>1. Disciplinska povreda koja se pretendira da je izvršio radnik, odnosno žalbe gradjana, može da se obrati i prijavi pismeno ili usmeno kod svakog radnika Policije, ili najbližu policijsku Stanicu od:</p> <p>1.1. Svakog državljanina Kosova, stranaca ili bez državljanstva, 1.2. Radnik Policije, 1.3. Radnika Inspektorata Policije Kosova, 1.4. Predstavnik pravnih lica, 1.5. Predstavnik institucija javne administracije.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 41</b> <b>Ankesat e qytetarëve</b></p> <p>1. Punonjësi i Policisë pas marrjes së</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 41</b> <b>Citizen's complaints</b></p> <p>1. Police employee after taking the</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 41</b> <b>Žalbe gradjana</b></p> <p>1. Radnik Policije nakon prijema</p>

<p>ankesës është i obliguar ta bëjë regjistrimin me shkrim të ankesës, dhe të ndërmarrë çdo lloj veprimi të nevojshëm dhe të arsyeshëm me qëllim të marrjes apo ruajtjes së dëshmive që kanë të bëjnë me sjelljen për të cilën është bërë ankesa.</p> <p>2. Asnjë personi nuk duhet t'i mohohet e drejta për të paraqitur ndonjë ankesë e as që t'i thuhet të vijë apo thërrasë më vonë.</p> <p>3. Qytetari mund të paraqesë ankesë për sjelljet e këqija të punonjësve të Policisë:</p> <p>3.1. Personalisht apo me përfaqësues</p> <p>3.2. Me telefon</p> <p>3.3. Me postë</p> <p>3.4. Në mënyrë elektronike dhe</p> <p>3.5. Në mënyrë anonime</p> <p>4. Në afatin sa më të shkurtër, por jo më vonë se pesë (5) ditë nga pranimi dhe regjistrimi i ankesës, obligohet që ta procedojë në Inspektoratin Policor të Kosovës dhe t'ia dërgojë të gjitha shënimet me shkrim dhe çfarëdo dëshmie që është siguruar.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 42</b> <b>Inicimi i brendshëm</b></p> <p>1. Të gjitha shkeljet e dyshuara fillimisht duhet të trajtohen në nivel lokal,</p>	<p>complaint is obliged to do the registration of that complaint in writing, and to undertake any other necessary and reasonable action with the aim of taking and preserving evidences that has to deal with the behaviour for which the complaint was made.</p> <p>2. No person shall be denied to submit a complaint and neither to tell him to come or call later.</p> <p>3. The citizen may submit a complaint for bad behaviours of the Police employee:</p> <p>3.1. Personally or with representative</p> <p>3.2. By telephone</p> <p>3.3. By post</p> <p>3.4. Electronically and</p> <p>3.5. Anonymously</p> <p>4. In the shortest period of time, but not later than five (5) days from the admission and registration of the complaint, he is obliged to proceed it at the Kosovo Police Inspectorate and to send all written notes and any other provided evidence.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 42</b> <b>Internal initiation</b></p> <p>All alleged offences initially must be treated at the local level, respectively</p>	<p>žalbe dužan je da sačini pismeni upis žalbe, i da preduzme bilo kakvu vrstu obaveznog i opravdanog delovanja sa ciljem dobijanja ili čuvanja dokaza koje se rade sa ponašanjem za koje je podneta žalba.</p> <p>2. Ni jednom licu ne treba da mu se negira pravo prijave neke žalbe niti da mu se kaže da dodje ili pozove kasnije .</p> <p>3. Gradjanin može da podnese žalbu za loše ponašanje radnika Policije:</p> <p>3.1.Lično ili sa predstavnikom</p> <p>3.2.Sa telefonom</p> <p>3.3.Sa poštom</p> <p>3.4.Na elektronskoj formi i</p> <p>3.5.Na tajnom osnovu</p> <p>4. U što kraćem roku, a najkasnije pet (5) dana od prijema i upisa žalbe, obavezuje se da dostavlja u Inspektorat Policije Kosova, i da dostavi sve pismene podatke i svaki dokaz koji je obezbedjen.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 42</b> <b>Unutrašnje pokretanje</b></p> <p>Sve sumnjive povrede početno treba da se tretiraju na lokalnom nivo, tačnije u</p>
--	---	---

<p>përkatësisht në kuadër të njësisë ku është i sistemuar punonjësi i dyshuar. Pas kësaj, nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i punonjësit ose personi të cilin ai e autorizon, zhvillohet një hetim paraprak, për të konstatuar supozimet për shkelje të dyshuar dhe pas vlerësimit nga ana e mbikëqyrësit, varësisht nga kategorizimi i shkeljes veprohen në këtë mënyrë:</p> <p>1.1. Nëse shkeljet bëjnë pjesë në kategorinë e shkeljeve të lehta disiplinore, hetimet fillojnë dhe përfundojnë në nivel lokal sipas kategorisë së shkeljeve të lehta.</p> <p>1.2. Nëse njëra nga shkeljet bën pjesë në kategorinë e shkeljeve të rënda disiplinore, lënda e kompletuar i procedohet Drejtorisë së Standardeve Profesionale.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 43</b> <b>Inicimi i disiplinës sipas detyrës zyrtare</b></p> <p>1. Çdo mbikëqyrës i punonjësit të Policisë, Drejtoria e Standardeve Profesionale, çdoherë kur merr informatë nga individët apo mediat e shkruara dhe elektronike, radio, televizioni dhe interneti, fillon një hetim paraprak për konstatimin e supozimit të ekzistimit apo mos ekzistimit të shkeljeve disiplinore.</p>	<p>within the unit when the suspect in systemized. After this, a preliminary investigation is conducted by the direct supervisor of the employee or the person he authorizes in order to ascertain assumptions for any suspected offence and after the evaluation by the supervisor, depending on the categorization of the offence must be proceeded in this way:</p> <p>1.1. If the offences belong to the categorization of the minor disciplinary offences, the investigations must begin and complete at the local level according to the category of minor offences.</p> <p>1.2. If any of the offences belongs to the category of serious disciplinary offences, the completed case must be preceded to the Directorate of Professional Standards.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 43</b> <b>Initiation of the ex officio discipline</b></p> <p>1. Any supervisor of the Police employee, Directorate of professional Standards, any time receiving information from the individuals or written and electronic media, radio, TV and internet, begins a preliminary investigation to ascertain the assumption if disciplinary offence exists or not.</p>	<p>okviru jedinice gde je rasporedjen osumnjičeni radnik. Nakon ovog od strane neposrednog nadzornika radnika ili lica koje on ovlašćuje, odvija se jedna preliminarna istraga, da bih utvrdio pretpostavke za sumnjive povrede i nakon ocenjivanja od strane nadzornika, zavisno od kategorizacije povrede deluje se na sledeći način:</p> <p>1.1. Ukoliko povrede spadaju u kategoriju lakih disciplinskih povreda, istrage počinju i završavaju se na lokalnom nivou, prema kategoriji lakih povreda.</p> <p>1.2. Ukoliko jedna od povreda spada u kategoriju teških disciplinskih povreda, kompletan predmet dostavlja se Direkciji Profesionalnih Standarda.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 43</b> <b>Pokretanje discipline po službenoj dužnosti</b></p> <p>1. Svaki nadzornik radnika Policije, Direkcija Profesionalnih Standarda, uvek kada dobije informaciju od pojedinaca, pisanih i elektornskih medija, radio, televizije i interneta, počinje jednu prethodnu istragu da utvrdi pretpostavku postojanja ili nepostojanja disciplinske povrede.</p>
--	--	---

<p>2. Nëse gjatë hetimeve paraprake gjenden elemente të veprës penale, niveli lokal apo DSP-ja lëndën ia procedon IPK-së apo Departamentit të hetimeve të Policisë së Kosovës bazuar në Ligjin e IPK-së.</p> <p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI V MASAT DISIPLINORE DHE AUTORITETI VENDIMMARRËS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 44 Masat për shkelje të lehta disiplinore për punonjësit e PK-së</b></p> <p>1. Masat që mund të merren ndaj punonjësit të PK-së në rastet e shkeljeve të lehta disiplinore janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.1. Vërejtje me gojë;</li> <li>1.2. Vërejtje me shkrim;</li> <li>1.3. Ndalesë në pagë 5% deri 20% nga paga bruto deri në dy muaj;</li> </ol> <p>2. Krahas masave të përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shqiptohen edhe masa plotësuese:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>2.1. Këshillim mjekësor/psikologjik</li> <li>2.2. Ndalesë drejtimi të automjetit të PK-së deri 6 muaj dhe</li> <li>2.3. Transfer administrativ vetëm me masën disiplinore nga paragrafi 1.3 i</li> </ol>	<p>2. If during the preliminary investigations elements of the criminal act are found, the local level or DPS submits the case to KPI or Investigation Department of the Kosovo Police based on KPI Law.</p> <p style="text-align: center;"><b>CHAPTER V DISCIPLINARY MEASURES AND DECISION MAKING AUTHORITY</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 44 Measures for minor disciplinary offences for the KP employee</b></p> <p>1. Measures that can be taken to the KP employee in case of minor disciplinary offences are:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.1 Verbal warning;</li> <li>1.2 Written warning;</li> <li>1.3 Deduction in salary 5 to 20% gross salary to two months;</li> </ol> <p>2. In addition to the measures set out in the 1 paragraph of this article, may also be imposed the additional measure:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>2.1. Medical psychological advice and</li> <li>2.2. Prohibit of driving KP vehicle up to 6 months</li> <li>2.3. The administrative transfer only</li> </ol>	<p>2. Ukoliko tokom prethodne istrage nalaze se elementi krivičnog dela, lokalni nivo ili DPS predmet procesuiru IPK ili Istražnoj upravi Policije Kosova na osnovu Zakona IPK-a.</p> <p style="text-align: center;"><b>V POGLAVLJE DISCIPLINSKE MERE I ODLUČUJUĆI AUTORITET</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 44 Mere za lake disciplinske povrede za radnike PK-a</b></p> <p>1. Mere koje se mogu preduzeti protiv radnika PK-a u slučajevima lake disciplinske povrede su:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.1. Usmena opomena;</li> <li>1.2. Pismena opomena;</li> <li>1.3. Zabrana na platu 5% do 20% od bruto ličnog dohotka do dva meseca;</li> </ol> <p>2. Uporedo odredjenim merama iz stava 1 ovog člana mogu da se izriču i dopunske mere:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>2.1. Lekarsko/psihološko savetovanje;</li> <li>2.2. Zabrana upravljanja vozila PK-a do šest 6 meseci.</li> <li>2.3. Administrativni premeštaj samo</li> </ol>
--	---	--

<p>këtij neni.</p> <p>3. Me qëllim të menaxhimit të disiplinës në nivel lokal, ky udhëzim përcakton që, për shkeljet disiplinore të parapara si shkelje të lehta, për të cilat parashihet shqiptimi i masës disiplinore - vërejtje me gojë dhe vërejtje me shkrim, autoritet vendimmarrës për të vlerësuar, shqyrtuar dhe vendosur për shkeljet disiplinore dhe shqiptimin e masës disiplinore, varësisht prej nivelit të organizimit, është mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë/shefi i njësisë, drejtori i drejtorisë/departamentit.</p> <p>4. Para se të merret vendim për shqiptimin e masës disiplinore, autoriteti vendimmarrës ka detyrim që t'i identifikojë, verifikojë dhe shqyrtojë me ndershmeri dhe në tërësi faktet e rëndësishme. Në rastet kur nga autoriteti vendimmarrës ka paqartësi rreth procedurave, do të kërkohet ndihmë-udhëzime nga Drejtoria e Standardeve Profesionale.</p> <p>5. Për shkeljet e lehta disiplinore, për të cilat parashihet shqiptimi i masës disiplinore – ndalesë në pagë që nuk është më e vogël se 5 % e jo më e madhe se 20 % e pagës mujore bruto prej një muaji deri dy muaj: autoriteti i nivelit lokal pas</p>	<p>with the disciplinary measure from the paragraph 1.3 of this article.</p> <p>3. With the aim of managing the discipline in local level, this instruction shows, the disciplinary offences prescribed as minor violations for which is provided the impose of disciplinary measure – verbal and written warning, decision making authority to evaluate, review and decide about the disciplinary offences and imposing of disciplinary measure, depending on the organization level, by the direct supervisor/head of the unit, director of the directorate/department.</p> <p>4. Before taking the decision for imposing the disciplinary measure, the decision making authority is obliged to identify, verify and analyze honestly and as a whole the important facts. In cases when the decision making authority has obstacles about the procedures, there will be required assistance-instructions from the Directorate of Professional Standards.</p> <p>5. For minor disciplinary offences which provided for the imposition of disciplinary measure – deduction on salary that is not less than 5% and not higher than 20% of gross monthly salary from one to two months: after completion of investigations</p>	<p>disciplinskom merom iz stava 1.3 ovog člana.</p> <p>3. Sa ciljem menadžiranja discipline na lokalnom nivo, ovo upustvo određuje da, za predviđene disciplinske povrede kao lake povrede, za koje se predviđja izricanje disciplinske mere - usmena opomena i pismena opomena, odlučujući autoritet da bih ocenjiva, razmatrao i odlučio za disciplinsku povredu i izricanje disciplinske mere, zavisno od nivoa organizovanja, je neposredni nadzornik jedinice, Direktor Direkcije/Uprave.</p> <p>4. Pre donošenja odluke za izricanje disciplinske mere, odlučujući autoritet obavezan je da identifikuje, proveriti i razmatra pošteno i u celosti bitne dokaze. U slučajevima kada se u odlučujućem autoritetu postoje nejasnoće oko procedura, zatražiće se pomoć-upustvo od strane Direkcije Profesionalnih Standarda.</p> <p>5. Za lake disciplinske povrede, za koje se predviđja izricanje disciplinske povrede, - zabrana na lični dohodak koja nije manja od 5% a ne veća do 20 % mesečne bruto plate za jedan mesec do dva meseca: autoritet lokalnog nivoa</p>
--	--	--

<p>përfundimit të hetimeve, lëndën disiplinore me rekomandim nga paragrafi 1.3 ia procedon KBD-së për vendimmarrje.</p> <p>6. Mbikëqyrësit e punonjësit të policisë kanë të drejtë që të shqiptojnë masën administrative ndalese e mëditjes për një ditë të humbur të punës brenda një muaji dhe më së shumti 3 ditë brenda vitit.</p> <p>6.1. Mbikëqyrësi i punonjësit nëse me arsye gjen se punonjësi është paraqitur në punë i pa rregullt, me vonesë, i pa përgatitur fizikisht dhe psikikisht (i lodhur, pa gjumë, nën ndikim të medikamenteve etj), i mungojnë pajisjet personale për punë, i pa rregullt në paraqitje (i pa rruar, nënqethur, rroba të pa pasteta, pa kapelë etj.), kundërmim të alkoolit apo kundërmim të keq.</p> <p>6.2. Mbikëqyrësit e punonjësve me rastin e shqiptimit të masës administrative ndalës në mëditje, lëshon vendim të menjëhershëm.</p> <p>6.3. Punonjësi që i jepet masa administrative ndalesë në mëditje mund të largohet nga ambientet e punës dhe në afatin prej 24 orësh përmes mbikëqyrësit vendimarrës ka të drejtë ankese të udhëheqësi më i lartë i nivelit lokal. Vendimi i udhëheqësit më të lartë të nivelit lokal është përfundimtar.</p>	<p>the local level authority submits the disciplinary case with recommendation from paragraph 1.3 to the IDC for decision-making.</p> <p>6. Superiors of the police employee have the right to impose the administrative measure reduction of the daily pay for one lost day within the month and up to 3 three days within the year.</p> <p>6.1. If the superior of employee reasonably finds that the employee comes to work improperly, late, physically or psychically not prepared (tired, sleepless, under the medication affect, etc) lacks equipments for work, improper appearance (unshaved, uncut hair, dirty clothed, without cap, etc), with alcohol smell or with a bad smell.</p> <p>6.2. Superiors of the employees in case of imposing the administrative measure, reduction in daily payment, issue an immediate decision.</p> <p>6.3. The employee who is given the administrative measure, reduction in daily payment must be removed from the working environment and has the right of complain within 24 hours through his superior who has issued the decision for the highest local lever leader. Decision of the highest local level leader is final.</p>	<p>nakon završetka istrage, disciplinski predmet na preporuku iz stava 1.3 dostavlja UDK-ji na odlučivanje.</p> <p>6. Nadzornici radnika Policije imaju pravo da izričuju administrativnu meru obustava dnevnice za jedan izgubljeni radni dan u mesecu a najviše tri dana u godini.</p> <p>6.1. Nadzorni radnika ukoliko opravdano nalaze da je radnik ne pravilno javio na posao, zakasnio, fizički i psihički nespreman (umoran, nespavan ili pod uticajem medikamenta itd) nedostaje mu lična oprema za rad, ne prikladan za predstavljanje (ne obrijan, ne ošišan, nečisto modelo, bez kape itd.) snrdi na alkool ili loš smrad.</p> <p>6.2. Nadzornici radnika prilikom izričenja administrativne mere obustave dnevnice, donosi trenutnu odluku.</p> <p>6.3. Radniku kome se daje administrativna obustava dnevnice treba da se udalji sa radnog ambijenta i ima pravo kalbe u toku 24 sati preko nadzornika koji je doneo odluku za višeg rukovodioca lokalnog nivoa. Odluka višeg rukovodioca lokalnog nivoa je konačna.</p>
---	--	---

<p>7. Me rastin e inspektimit, ndalesën e meditjes për një ditë pune, në rrethana të njëjta mund ta shqiptojë edhe Njësia e inspektimit. Ndaj këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të bëjë ankesë tek eprori i drejtpërdrejt brenda 24 orëve.</p> <p>8. Përsëritja e shkeljeve të njëjta për të cilat është marr vendim administrativ për ndalësë në meditje sipas paragrafit 6 të këtij neni (ndalesa e më shumë se e tri meditjeve brenda vitit), do të rezultoj me mas progresive, duke mos e përjashtuar edhe iniciimin e procedurës disiplinore.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 45</b> <b>Masat për shkelje të rënda disiplinore për punonjësit e PK-së</b></p> <p>1. Masat që mund të merren ndaj punonjësit të PK-së në rastet e shkeljeve të rënda disiplinore janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.1. ndërprerja e marrëdhënies së punës,</li> <li>1.2. degradim - jo më shumë se një gradë</li> <li>1.3. largim nga pozita komanduese apo largim në një pozitë tjetër me përgjegjësi me të ultë menaxhuese por pa e humbur gradën dhe kategorinë</li> </ol>	<p>7. Upon inspection, reduction of daily payment, in the same circumstances could pronounce the Inspection unit. Against this decision, the party may make a appeal to the direct supervisor within 24 hours.</p> <p>8. Repeating same offences for which there has been taken an administrative decision on deduction of per diems according to the paragraph 6 of this article (deduction of more than three per diems during the year), shall result with a progressive measure, not excluding the initiation of the disciplinary procedure.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 45</b> <b>Measures for serious disciplinary offences for the KP employees</b></p> <p>1. Measures that may be taken against the KP employee in cases of serious disciplinary offences are:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.1. Termination of work relation</li> <li>1.2. degradation – not more than one rank</li> <li>1.3. removal from the commanding position or into another position with the lowest managing responsibility but without losing the rank and functional category</li> </ol>	<p>7. Nakon inspekcije, obustavu dnevnice za jedan radoni dan, pod istim uslovima moze da izrice Jedinica za inspekciju. Protiv ove odluke, nezadovoljna strana može da ulozi zalbu direktnom predpostavljenom u roku od 24 sata.</p> <p>8. Ponavljanje 89 istih prekršaja za koje je doneta administrativna odluka za obustavu dnevnice prema stavu 6 ovog člana (obustava više od tri dnevnice u toku godine), rezultiraće sa progresivnom merom, a ne isključuje se i pokretanje disciplinskog postupka.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 45</b> <b>Mere za teške disciplinske povrede za radnika PK-a</b></p> <p>1. Mere koje se mogu preduzeti protiv radnika PK-a u slučajevima teške disciplinske povrede su:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.1. prekid radnog odnosa,</li> <li>1.2. degradiranje – ne više od jednog čina</li> <li>1.3. Udaljavanje sa komandnog poplozaja ili udaljavanje na neki drugi položaj sa niže menadžirajuću odgovornost ali bez gubitka čina i funkcionalne kategorije.</li> </ol>
---	---	--



<p>funkionale.</p> <p>1.4. ndalesën në pagë mbi 20% deri në 30% e pagës mujore bruto prej dy deri në gjashtë muaj.</p> <p>2. Krahas masave të përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shqiptohen edhe masat plotësuese:</p> <p>2.1. Transfer administrativ;</p> <p>2.2. Trajnim obligativ;</p> <p>2.3. Këshillim mjekësor/psikologjik dhe</p> <p>2.4. Ndalesë drejtimi të automjetit të PK-së deri në 1 vit.</p>	<p>1.4. deduction in salary over 20 up to 30% of gross monthly salary from two to six months.</p> <p>2. In addition to the measures set out from the 1 paragraph of this article may also be imposed the additional measures:</p> <p>2.1. Administrative transfer;</p> <p>2.2. Mandatory training;</p> <p>2.3. Medical/psychological advice and</p> <p>2.4. Prohibit of driving KP vehicle up to 1 years.</p>	<p>1.4. obustava na platu iznad od 20%-30% bruto mesečne plate od dva do šest meseca.</p> <p>2. Upredo odredjenim merama iz stava 1 ovog člana mogu se izricati i dopunske mere:</p> <p>2.1. Administrativni premeštaj;</p> <p>2.2. Obavezna obuka;</p> <p>2.3. Lekarsko/psihološko savetovanje i</p> <p>2.4. Zabrana upravljanja vozilima PK-a do 1 godine.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 46</b> <b>Autoriteti për trajtim, shqyrtim, shqiptim dhe rekomandim të masave disiplinore</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 46</b> <b>Authority for treatment, review, impose and recommand of disciplinary measures</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 46</b> <b>Autoritet za tretiranje, razmatranje, izricanje i preporuke disciplinskih mera</b></p>
<p>1. Autoriteti për trajtim, shqyrtim dhe shqiptim të masave disiplinore janë:</p> <p>1.1. Mbikëqyrësi i punonjësit;</p> <p>1.2. Komisioni i Brendshëm Disiplinor;</p> <p>1.3. Komisioni për Ankesa dhe Shpërblime;</p> <p>1.4. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë të gjitha masat disiplinore sipas kompetencës nga ligji i IPK-së;</p> <p>1.5. Ministri i MPB-së si shkallë e dytë dhe Kryeministri sipas ligjit të Policisë dhe IPK-së.</p>	<p>1. Authority for treatment, review and impose of disciplinary measures are:</p> <p>1.1. Employees supervisor;</p> <p>1.2. Internal disciplinary commission;</p> <p>1.3. Commission for appeals and rewards;</p> <p>1.4. General Director of Police all disciplinary measures according to the competencies from KPI law;</p> <p>1.5. Minister of MIA as a second level and the Primeminister according to the Police law and KPI.</p>	<p>1. Autoritet za tretiranje, razmatranje i izricanje disciplinskih mera su:</p> <p>1.1. Nadzornik radnika;</p> <p>1.2. Unutrašnja Disciplinska Komisija</p> <p>1.3. Komisija za žalbe i nagradjivanje;</p> <p>1.4. Generalni Direktor Polilcije sve disciplinske mere prema nadležnosti zakona IPK-a;</p> <p>1.5. Ministar MUP kao drugi stepen i Premijer pema Zakonu o Policiji i IPK.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 47</b> <b>Suspendimi i përkohshëm nga Policia e Kosovës</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 47</b> <b>Temporary suspension from the Kosovo Police</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 47</b> <b>Priveremena suspenzija sa Policije Kosova</b></p>
<p>1. Punonjësi i Policisë suspendohet përkohësisht me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm në bazë të rekomandimit të IPK-së, DSP-së, si dhe KBD-së në situatat e parapara në paragrafin 3.3 të këtij neni.</p> <p>2. Suspendimi nuk është masë disiplinore dhe nuk guxon të jepet për ndëshkim të punonjësit.</p> <p>3. Punonjësi mund të suspendohet nën këto rrethana:</p> <p>3.1. Kur dyshohet se ka kryer veprë penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare e që punonjësin e bën të pa përshtatshëm përkohësisht për kryerjen e detyrës, sjellja e punonjësit ndikon në uljen e reputacionit dhe besimit në PK, apo nëse punonjësit i është kufizuar liria nga organet e zbatimit të ligjit;</p> <p>3.2. Kur dyshohet se ka kryer shkelje veçanërisht të rënda disiplinore të cilat veprime ndikojnë në uljen e reputacionit dhe besimit në Policinë e Kosovës;</p> <p>3.3. Nëse ndaj punonjësit shqiptohet masa disiplinore Ndërprerje e</p>	<p>1. The police employee may be suspended temporarily with the general director decision, based on the recommendation of KPI, DPS, as well as IDC on the situations foreseen in the paragraph 3.3 of this article.</p> <p>2. Suspension is not disciplinary measure and should not be given to punish the employee.</p> <p>3. The employee may be suspended under these circumstances:</p> <p>5.1. When suspected that the employee has committed criminal offence punishable according to the official duty and which makes the employee temporarily improper to perform his duty, behavior of the employee impacts in decreasing the reputation and liability in KP, or the employee has been deprived in freedom by the law enforcement bodies;</p> <p>5.2. When suspected of having committed serious criminal offence, which impact in decreasing the reputation and liability in Kosovo</p>	<p>1. Radnik Policije privremeno se suspendira odlukom Generalnog Direktora na osnovu preporuke IPK-a ili DPS-a i UDK u situacijama predvidjenih stavom 3.3. ovog člana.</p> <p>2. Suspenzija nije disciplinska mera i ne sme da se da kao kazna radnika .</p> <p>3. Radnik može da se suspendira u ovim okolnostim</p> <p>3.1. Kada se sumnja da je izvršio krivično delo za koje se goni prema službenoj dužnosti što radnika ulini privremeno neprikladnim za izvršenje dužnosti, ponašanje radnika utiče na umanjenje ugleda i poverenja u PK-u, ili ukoliko je radniku ograničena sloboda od strane organa sprovođenja zakona;</p> <p>3.2. Kada se sumnja da je izvršio povredu, posebno tešku disciplinsku povredu koje utiču na umanjenje ugleda i poverenja u Policiji Kosova;</p> <p>3.3. Ukoliko protiv radnika izriče</p>

<p>marrëdhënies së punës nga autoriteti vendimmarrës në shkallë të parë, deri në plotfuqishmërinë administrative të vendimit disiplinor.</p> <p>3.4. Nëse punonjësi i suspenduar pas përfundimit të seancës shpallët i pafajshëm, autoriteti vendimmarrës, KBD ose KA, i rekomandon zyrës së Drejtorit të përgjithshëm, ndërprerjen e suspendimit.</p> <p>3.5. Nëse punonjësi shpallet fajtor dhe i shqiptohet masa disiplinore “ndërprerje e marrëdhënies së punës”, autoriteti vendimmarrës, KBD, i rekomandon zyrës së Drejtorit të përgjithshëm suspendimin e përkohshëm deri në vendimin tjetër administrativ.</p> <p>3.6. Nëse Komisioni për Ankesa merr vendim për ndryshimin e masës disiplinore nga masa disiplinore “ndërprerje e marrëdhënies së punës” në ndonjë masë tjetër më të lehtë, KA obligohet t’i rekomandojë zyrës së Drejtorit të përgjithshëm ndërprerjen e suspendimit.</p> <p>4. Drejtori i departamentit është i autorizuar që të suspendojë punonjësin përkohësisht në kohëzgjatje deri 48 orë nën rrethanat e krijuara siç parashihet në paragrafin 3, nënparagrafi 3.1 1 dhe 3.2 të këtij neni.</p>	<p>Police;</p> <p>5.3. If against the employee is imposed the disciplinary measure Termination of work relation by the decision-making authority of the first level, up to the final administrative disciplinary decision.</p> <p>5.4. If the suspended worker after the closing session is declared innocent, decision-making authority, IDC or CA, recommends to the office of Director General, termination of the suspension.</p> <p>5.5. If the employee is found guilty and against him/her is imposed the disciplinary measure "termination of employment", decision-making authority, CBD, recommends to the Office of the Director General the temporary suspension until further administrative decision.</p> <p>5.6. If Appeals Commission decides to change the disciplinary action of termination of employment to any other lighter measure CA is obliged to recommend to the office of Director General the termination of suspension.</p> <p>4. The director of the respective police department has the authorization to suspend the employee temporarily for a period up to 48 hours under the circumstances foreseen in paragraph 3 subparagraph 3.1 1 and 3.2 of this article.</p>	<p>se disciplinska mera “prekid radnog odnosa” od strane odlučujućeg autoriteta prog stepena do administrativne pravosnažnosti disciplinske odluke.</p> <p>3.4. Ako suspendovani radnik posle završne sednice je proglašen nevinim, donosi odluke, UDK ili KŽ, preporučuje kancelariji generalnog direktora, prestanak suspenzije.</p> <p>3.5. Ako je zaposleni oglašen krivim i protiv radnika izriče se disciplinska mera "prestanak radnog odnosa", odlučujući autoritet, UDK, preporučuje kancelariju Generalnog Direktora privremenu suspenziju do donošenja druge administrativne odluke.</p> <p>3.6. Ako komisija za žalbe donosi odluku da promeni disciplinsku meru od "prestanak radnog odnosa" u bilo koju lakšu meru KŽ je dužan da predloži kancelariju Generalnog Direktora prestanak suspenzije.</p> <p>4. Direktor dotične policijske uprave ima ovlašćenje da radika privremeno suspendira vremenskom trajanju od 48 časova pod ostvarenim okolnostima kao što se predvidja pod stavom 3.1 1 i 3.2 ovog člana.</p>
---	--	---

<p>5. Në afatin prej 48 orësh të suspendimit në nivel lokal, nuk përfshihet periudha kohore që hynë në ditët e pushimit javor (vikend).</p> <p>6. Afati maksimal i suspendimit me pagesë është në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, periudhë pas të cilës punëdhënësi është i obliguar që të punësuarin ta kthej në punë ose t'i shkëpus kontratën e punës, përveç rasteve kur punonjësi është nën procedurë penale dhe ndaj tij është ngrit Akti Akuzues, suspendimi vazhdon deri në përfundimin e procedurës penale, përkatësisht nxjerrjes së aktgjykimit të plotfuqishëm.</p> <p>7. Ndaj vendimeve nga paragrafi 3 dhe 4 e këtij neni, zyrtari i suspenduar nuk ka të drejtë ankese.</p> <p>8. Autoriteti i nivelit lokal ka për detyrë që në afatin sa më të shkurtër por jo më vonë se 24 orë pas suspendimit të kompletojë lëndën disiplinore dhe ta dërgojë tek IPK-ja nëse është incidenti vepër penale ose DSP-ja nëse është shkelje disiplinore.</p> <p>9. IPK-ja apo DSP-ja i bëjnë rekomandim me arsyetim, me shkrim, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për vazhdimin e</p>	<p>5. Within 48 hours of the suspension in local level, the period of time that iso f weekend rest days is not included.</p> <p>6. The maximum period of suspension of payment is in timeline of six (6) months, after which period, the employer is obliged to return the employee at work or to terminate the working contract, except the cases when the employee is under criminal proceeding and against him a charge was made, the suspension continous up to the termination of the criminal proceeding, respectively issuance of the final decision.</p> <p>7. To the decisions from 3 and 4 point of this article, the suspended officer has not the right to appeal.</p> <p>8. Local level authority has the duty that within the shortest possible time but not later than 24 hours after suspension to complete the disciplinary case and send it to the KPI is the incident is criminal act or to the DPS if it is disciplinary offence.</p> <p>9. KPI or DPS makes a written recommendation with reasoning to the general director of Police to continue the</p>	<p>5. U roku od 48 casova suspendiranja u lokalnom nivou ne predvidja se vremenski period koji spada u danima nedeljnog odmora (vikenda).</p> <p>6. Maksimalni rok plaćene supenzije u vremenskom trajanju je od šest (6) meseci, period posle kojeg poslodavac je obavezan da zaposlenog vrati na posao ili da prekida ugovor o radu, osim slučajeva kada je radnikpod krivičnom procedurom i protiv njega pokrenut je akt optužbe, suspendiranje nastavlja se do okončanja krivične procedure, odnosno do donošenja pravosnažne presude.</p> <p>7. Protiv odluke iz tačke 3 i 4 ovog člana suspendovani službenik nema pravo žalbe.</p> <p>8. Autoritet lokalnog nivoa dužan je da u što kraćem roku a najkasnije do 24 sata nakon supezije da kompletira disciplinski predmet i da dostavi kod IPK-a ukoliko je incident krivično delo ili DPS-da ukoliko je disciplinska povreda</p> <p>9. IPK ili DPS- urade opravdanu pismenu preporuku Generalnom Direktoru Policije za produženje</p>
---	--	---

<p>suspendimit, nëse nuk bëjnë rekomandim për vazhdim të suspendimit, nënkuptohet se ndërprehet suspendimi pasi të kaloj periudha prej 48 orëve.</p> <p>10. Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm e bën përgatitjen dhe shpërndarjen e vendimeve për suspendim.</p> <p>11. Me pushimin e rrethanave dhe arsyeve që kanë sjell suspendimin, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ndërpret suspendimin me rekomandimin e drejtorit të Drejtorisë për Standarde Profesionale apo IPK-së.</p> <p>12. Gjatë kohës së suspendimit nga puna, të punësuarit i takon e drejta e kompensimit në pagë në lartësi prej 50% të pagës bruto;</p> <p>13. Pas përfundimit të procedurës disiplinore, nëse punonjësi i suspenduar pa marr parasysh intervalin kohore, lirohet nga akuzat të cilat e kanë sjell suspendimin, punonjësit i takon kompensimi i ndalesave përgjatë suspendimit.</p> <p>14. Punonjësi përkohësisht i suspenduar është i obliguar që t'u përmbahet obligimeve që dalin nga ky udhëzim.</p>	<p>suspension, if no recommendations are made for continuing the suspension, it is understood that the suspension is terminated after the period of 48 hours.</p> <p>10. General director office prepares and delivers the decision for suspension;</p> <p>11. With the cessation of circumstances and the reasons which brought to suspension, general director of Police terminates suspension with the recommendation of the Directorate of Professional Standards or KPI.</p> <p>12. During the suspension time, the employee has the right of compensation in salary in amount of 50% of the gross salary.</p> <p>13. After completing of the disciplinary procedure, if the suspended employee without regard to the time interval, is relieved from the charges which brought the suspension, the employee has the right of compensation for the reductions during the suspension.</p> <p>14. Temporarily suspended employee is obliged to comply with the obligations arising from this instruction.</p>	<p>suspenzije, ukoliko ne vrše preporuku za nastavak suspendiranja, podrazumeva se da se prekine suspendiranje nakon što prolazi period od 48 časova.</p> <p>10. Kancelarija Generalnog Direktora obavlja pripremu i raspodelu odluka za suspendiranje.</p> <p>11. Po prestanku okolnosti i razloga koji su doveli do suspendiranja, Generalni Direktor Policije, prekida suspenziju po preporuku Direktora Direkcije za Profesionalne Standarde ili IPK.</p> <p>12. Tokom vremena suspenzije sa rada zaposlenom pripada pravo naknade u visini od 50% bruto od ličnog dohotka.</p> <p>13. Nakon okončanja disciplinske procedure, ukoliko suspendirani radnik bez obzira na vremenski period, oslobadja se od optužbe koja ga je dovela do suspenzije, radniku mu sledi nadoknada obustave tokom suspenzije.</p> <p>14. Radnik privremeno suspendovan dužan je da se pridržava obavezama koje proizlaze iz ovog Uputstva.</p>
--	--	--

<p>15. Punonjësi i Policisë derisa është përkohësisht i suspenduar me pagesë nga puna është i obliguar që ta dorëzojë kartelën identifikuese, armën zyrtare dhe pajisjet policore tek mbikëqyrësi i tij/saj.</p>	<p>15. Police employee while temporarily suspended with pay, is obliged to submit ID card, official weapon and other police equipments to his/her supervisor.</p>	<p>15. Radnik Policije dok je privremeno plaćeno suspendava sa rada obavezan je da preda identifikacionu karticu, službeni pištolj i policijsku opremu kod njegovog/njenog nadzornika.</p>
<p>16. Gjatë kohës së suspendimit të përkohshëm, punonjësi nuk lejohet që të kryejë detyra policore as punë sekondare, por i lejohet puna dytësore . Gjatë kohës sa është nën suspendim, punonjësi ka detyrim t'u përmbahet dispozitave dhe akteve tjera nënligjore si çdo pjesëtar tjetër i policisë.</p>	<p>16. During the temporarily suspension the employee is not allowed to perform police duties or secondary jobs, but he is allowed in secondary jobs. During the time he is under the suspension he is obliged to comply provisions and other sub-legal acts as other police members.</p>	<p>16. Tokom vremena privremene suspenzije, radniku se ne dozvoljava da izvršava policijske dužnosti niti sekundarne poslove ali dozvoljava mu se da radi druge poslove. Tokom vremena dok je pod suspenzijom radnik je obavezan da se pridržava odredbama i drugim podzakonskim aktima kao svaki drugi pripadni Policije.</p>
<p>17. Punonjësit përkohësisht të suspenduar i kufizohet hyrja në objekte dhe automjetet e Policisë pa pëlqim paraprak, përveç rasteve kur ka nevojë të hyjë në objekte policore dhe merr leje, si dhe kur ftohet zyrtarisht.</p>	<p>17. Temporarily suspended employee is restricted to enter in police facilities and vehicles without prior consent, except in case if he needs to enter in police facilities and receives a permit, as well as when officially invited.</p>	<p>17. Privremeno suspendovanom radniku se ograničava ulaz u objektima i vozilima Policije, bez prethodne saglasnosti, osim u slučajevima kada ima potrebu da ulazi u policijske objekte uz dozvolu, kao i kada se službeno pozove.</p>
<p>18. Çdo vështirësi me të cilën ballafaqohet punonjësi përkohësisht i suspenduar në mbajtjen e kontaktit me mbikëqyrësin e caktuar duhet të raportohet tek udhëheqësi me i lart i nivelit lokal.</p>	<p>18. Any difficulty, by which the temporarily suspended employee faces in keeping contacts with the assigned supervisor, should be reported to the hights leader of the local level.</p>	<p>18. Svaka poteškoča sa kojom se suočava privremeno suspendovani radnik u održavanju kontakata sa odredjenim nadzornikom treba da se izveštava kod višeg rukovodioca lokalnog nivoa.</p>
